



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Kuvendi i Komunës Klinë

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

01Nr 06-19627 /25

Klinë, dt: 30.06 /25

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tretë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur më 11.06.2025, me fillim nga ora 16:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryetari i Komunës, z. Zenun Elezaj, me një fjalë përshëndetëse për të gjithë anëtarët, ku përgëzoi punën e bërë për tri vite të Nënkrjetares, e cila është udhëheqëse e KKSBS-së.

Pastaj shpalosi pikat e rendit të ditës, të cilat u trajtuan sipas radhës.

RENDI I DITËS

1. Diskutim për aktivitete të organizuara nga Drejtoria e Arsimit për maturantët;
2. Prishja e rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm;
3. Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror dhe vërshimet gjatë vitit;
4. Plani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave;
5. Të ndryshme.

Pika 1. Diskutim për aktivitete të organizuara nga Drejtoria e Arsimit për maturantët.

Fjalën e mori drejtori i Arsimit, **z. Qemajl Sejdi**. Ai tha se organizime të tilla mbahen çdo fundvit dhe, në përgjithësi, organizohen nga shkollat, me pjesëmarrje edhe të policisë. Ne kemi kërkuar nga Ministria dhe nga shkollat e tjera bashkëpunim për mbarëvajtjen e organizimeve, si dhe kemi kërkuar një buxhet të pjesshëm për maturën. Dëshiroj të falënderoj të gjitha shkollat për organizimin e suksesshëm dhe pa probleme të aktiviteteve. Mbetet që, në bashkëpunim me Kryetarin, në vitet e ardhshme të shqyrtojmë kapacitetin buxhetor në konsultim me shkollat dhe Drejtorinë e Arsimit. Drejtoria e Arsimit është në përgatitje të testit të maturës dhe u dëshiron sukses të gjithë maturantëve.

Pika 2. Prishja e rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm.

Fjalën e mori zyrtari i Policisë, **z. Skënder**, i cili përshëndeti të pranishmit dhe tha se sa i përket gjendjes së sigurisë për lokalet e natës dhe sigurinë e përgjithshme në komunë, janë në zbatim disa plane operative. Ai theksoi se lokalet e natës kanë pasur problematika të theksuara, sidomos gjatë vitit të fundit. Aktualisht, janë vetëm dy lokale nate që funksionojnë gjatë gjithë natës dhe për to kryhen kontrole të rregullta. Dy herë janë bastisur, por nuk është gjetur asgjë e paligjshme. Ka raste në qendër të Klinës me prishje të rendit dhe qetësisë publike.

Ai paraqiti statistikën për muajin maj: janë iniciuar 54 raste, nga të cilat 31 kanë qenë vepra penale; ka pasur 27 aksidente trafiku, 5 prej tyre me lëndime trupore; janë shqiptuar 871 tiketa për kundërvajtje; ka pasur 7 të lënduar dhe 13 të arrestuar për vepra penale, nga të cilët 5 janë ndaluar. Janë konfiskuar 3 armë dhe 14 fishekë të kalibrave të ndryshëm. Janë realizuar gjithashtu 6 asistime të ndryshme. Për veprat penale të rënda, kundër jetës dhe rendit kushtetues, nuk ka pasur raste – vetëm dy lëndime të lehta trupore.

Ka pasur një rast vjedhjeje dhe disa raste vjedhjesh të rënda në zona të ndryshme të qytetit: në Gremnik (2 raste), në Klinafç (2 raste) dhe disa edhe në qendër të qytetit, ku cak kanë qenë shtëpitë e braktisura të bashkatdhetarëve. Grabitje nuk ka pasur. Dhuna në familje është evidentuar në 3 raste gjatë muajit maj.

Hetimet për veprat penale kanë rezultuar me 80% identifikim të kryesve dhe po punohet për arrestimin e tyre dhe sjelljen para drejtësisë. Ai njoftoi se janë në përgatitje të planit operativ për sezonin veror, kur pritet rritje e qarkullimit dhe shtim i numrit të banorëve për shkak të ardhjes së bashkatdhetarëve. Plani përfshin monitorimin e dasmave, ahengjeve dhe të shtënave me armë zjarri, si dhe menaxhimin e trafikut. Qëllimi është ruajtja e qetësisë dhe stabilitetit.

Më pas fjalën e mori Kryetari i Komunës, **z. Zenun Elezaj**, i cili e falënderoi për informacionin dhe kërkoi nga Policia organizim të mirë dhe stabilitet në qytetin e Klinës.

Pika 3. Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror dhe vërshimet gjatë vitit.

Më pas Kryetari i Komunës kaloi në pikën e tretë të rendit të ditës, që kishte të bënte me përgatitjet për sezonin dhe mbrojtjen nga zjarri. Qyteti i Klinës është një ndër komunat që graviton më së shumti rreth lumenjve, ku ndodhen gjashtë të tillë. Këta lumenj përbëjnë dukuri natyrore të bukura, por shpeshherë krijojnë dëme për shkak të vërshimeve.

Komuna ka ndërmarrë ndërhyrje financiare për të pasur stabilitet në rregullimin e shtratit të lumenjve. Gjatë dy viteve të fundit kemi pasur kërkesa të mëdha drejtuar donatorëve dhe kemi gëzuar mirëkuptim të plotë nga Qeveria dhe organizata të ndryshme si USAID, për mbështetjen e një projekti të fizibilitetit. Ky projekt kishte për qëllim implementimin e një plani për menaxhimin e lumenjve, por fatkeqësisht është ndërprerë si pasojë e ndryshimeve politike gjatë administratës Trump. Megjithatë, aktualisht kemi një donator të ri – GIZ-in – i cili do të mbështesë realizimin e një projekti të madh e të qëndrueshëm, me përfshirjen e ekspertëve të fushave përkatëse.

Sa i përket sezonit të verës dhe rrezikut nga zjarret, u shpreh falënderim për Njësinë e Zjarrfikësve dhe punën e tyre të palodhur. I pranishëm ishte edhe komandanti i Njësisë së Zjarrfikësve, z. Elmi Zenunaj. Kryetari tha se, për të mos e lënë komandantin të ankohej, të gjithë janë të vetëdijshëm për kushtet e vështira në të cilat punojnë zjarrfikësit. Ata e kryejnë punën vetëm me dy kamionë, dhe Komuna vazhdimisht investon për mirëmbajtjen e tyre. Megjithatë, gjatë sezonit të djegieve nuk arrihet mbulimi i të gjitha zonave, për shkak të kapaciteteve të kufizuara dhe kushteve në të cilat ata operojnë

Pika 4. Plan i operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave.

Më pas Kryetari kaloi në pikën e katërt të rendit të ditës, e cila kishte të bënte me planin operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave. U theksua gatishmëria e Policisë së Kosovës, e cila ka parashikuar zgjidhje alternative në menaxhimin e situatës. Megjithatë trafiku paraqet një sfidë të madhe gjatë kësaj periudhe, qytetarët ruajnë respekt të veçantë për mërgimtarët që kthehen në vendlindje për pushime.

Policia është e angazhuar në organizimin dhe kontrollin e qarkullimit rrugor. Pritet një sezon i vështirë, pasi projektet infrastrukturore – sidomos rruga Pejë–Prishtinë – kanë ngecur. Lidhur me këtë çështje, Kryetari njoftoi për një takim që ka pasur me Ministrin e Infrastrukturës, ku është kërkuar përsheptimi i procedurave me qëllim që të krijohet të paktën një qasje në zonën e Gremnikut, që konsiderohet pika më e ndjeshme në Klinë.

Ai vuri në dukje se ditët e fundit është vërejtur një intensifikim i punimeve, ndërkohë që Komuna ka planifikuar edhe një investim për shtrimin e zhavorrit si zgjidhje e përkohshme. Është bërë një plan për krijimin e një drejtimi të përkohshëm që do të ndihmojë në lehtësimin e qarkullimit. Kryetari iu drejtua Policisë me një thirrje që të shtohet vëmendja tek rruga “Ndue Përlleshi” dhe të bëhet orientimi i automjeteve në mënyrë që të shmangen bllokimet në komunikacion.

Pika 5. Të ndryshme.

Fjalën e mori z. Josip Dedaj, i cili shprehu një shqetësim duke thënë se kishte dëgjuar – pa qenë

i sigurt nëse ishte dezinformatë apo e vërtetë – që në fshatin Dresnik do të ndërtohej një xhami e madhe.

Kryetari, **z. Zenun Elezaj**, u përgjigj se nuk është në dijeni për një projekt të tillë.

Megjithatë, **z. Dedaj** insistoi se Kryetari është i informuar, por **z. Elezaj** sërish u shpreh se nuk ka njohuri për këtë çështje dhe se do të marrë informacione më të hollësishme, për t'i informuar të gjithë pjesëmarrësit më tej.

Më pas fjalën e mori **përfaqësuesi i Bashkësisë Islame, hoxha**, i cili tha se edhe ai nuk është në dijeni për ndërtimin e një xhamie në atë lokacion, por konfirmoi se një qytetar ka dhuruar një parcelë toke për Bashkësinë Islame. Megjithatë, nëse do të ndërtohet xhami apo jo, nuk ka asnjë informacion zyrtar.

Mbledhja përfundoi me një përshëndetje nga z. Zenun Elezaj drejtuar të gjithë të pranishmëve.

Procesmbajtësja,
Vjosa Gjetaj

